



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 49 Prot.

Tiranë, më 15.01 2019


**VENDIM Nr. 20, datë 15.01.2019**

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 1, datë 15.01.2019, pasi shqyrtoi kërkesën për miratim projekti *"Rikonceptim dhe rikonstruksion i shkollës "Jan Kukuzeli"*, rruga "Kristoforidhi", zona arkeologjike "B", Durrës-subjekti Bashkia Durrës, relacionin e potencialit arkeologjik dhe konceptin e sondazheve arkeologjike paraqitur nga subjekti i licencuar në arkeologji "AD - STAR" sh.p.k.,

**VENDOSI:**

1. Bashkia Durrës duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje katër palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, DRKK Durrës dhe ASHA, të cilët duhet të ndjekin në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "Rikonceptim dhe rikonstruksion i shkollës "Jan Kukuzeli", rruga "Kristoforidhi", zona arkeologjike "B", Durrës.
2. Pas lidhjes së akt-marrëveshjes së sipërpërmendur, të vijojë procedura e shqyrtimit dhe vendimmarrjes në organet përkatëse të qeverisjes vendore dhe pas paisjes me lejen përkatëse, të fillojnë punimet e gërmimit, të cilat do realizohen sipas akt-marrëveshje katër palëshe të cituar në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrisë Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO FURXHI  
MINISTËR



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)